



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE DHE PUNËVE PUBLIKE

Raporti teknik

Objekti : Shërbimi i Pastrimit Bashkia Shkoder Zona Qendrore
Burimi I financimit : Buxheti i Bashkise miratuar me VKB Nr. 55 Prot. date 29.12.2023
Afati i realizimit : **24 muaj**
Fondi preventivuar : **261,221,697.96 lekë me tvsh**
Vendodhja : **Shkoder, Qytet**

Gjendja aktuale

Aktualisht shërbimi i pastrimit në zonën Qendrore realizohet ne 100% te territorit, me sipërmarrës privat me një kontratë 1- vjecare që përfundon me 30 Prill 2024. Shërbimi i pastrimit të zonës qendrore është realizuar në dy menyra: shërbimi në zonën 1 per gjithë qytetin me konteniere publik, dhe shërbimin e pastrimit dere-me-dere për zonën 2, ku perfshihen pedonalet e qytetit. Zerat e shërbimit konsistojne ne:

- Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve me konteniere;
- Menaxhim dhe Mirembajtje kazanesh;
- Grumbullimi i mbetjeve me qese dere-me-dere;
- Dezinfektimi i pgm've;
- Fshirja Mekanike;
- Fshirja Manuale;
- Lagje e rrugeve;
- Larje e rrugeve;
- Mirembajtje e rrugeve kryesore dhe PGM.

Objektivi

Objektivi kryesor për Bashkinë Shkodër, është ofrimi i nje shërbimi cilesor per menaxhimin e mbetjeve te ngurta urbane ne zonen Qendrore. Zona Qendrore merr shërbimin e grumbullimit te mbetjeve me konteniere me frekuenca te shtuara. Gjithashtu duke ndjekur praktikat e mira te meparshme, Bashkia Shkoder do shtrije harten e shërbimit dere me dere duke reduktuar ndotjen e PGM-ve ne qytet dhe duke rritur performancen në grumbullimin e mbetjeve. Risi kete vit eshte parashikuar perdorimi i nje fshese mekanike te vogel e cila do perdoret per pastrimin e pistave ciklistike, dhe jo vetem. Larja e Pedonaleve eshte parashikuar te realizohet 24 here/vit duke perfshire dhe Pedonalet e Molos dhe Shirokes. Te gjitha shërbimet e parashikuara do te ndikojne direkt ne mbajtjen e ambientit paster, gje e cila sjell cilesi jetese me te mire per rezidentet si dhe e ben Qytetin nje destinacion me atraktiv per vizitoret vendas dhe te huaj.